



UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

N. Prot. 241

Tiranë, më 4/8/2025

**Kriteret dhe Procedurat e Pranimiit për Shtetasit Shqiptarë
në Programet e Studimit të Fakultetit të Mjekësisë
Raundi i Parë, Viti Akademik 2025-2026**

Fakulteti i Mjekësisë i Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" ofron Programin e Studimit Master Shkencor të Integruar në 'Mjekësi dhe Kirurgji' në gjuhën italiane.

Vendet e lira dhe kriteret e pranimiit

Në vitin akademik 2025-2026, në raundin e parë, vendet e disponueshme për kandidatët shqiptarë janë:

Programet e studimit	Vendet e disponueshme
Programi i Studimit Master Shkencor i Integruar në <i>Mjekësi dhe Kirurgji</i>	30

Kandidatët duhet të kenë përfunduar shkollën e mesme dhe të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- të kenë një un Diplomë të Shkollës të Mesme;
- të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 436 datë 03/06/2020, të ndryshuar me VKM nr.46 datë 27/01/2021 të Republikës së Shqipërisë, sipas së cilës mesatarja e notave të rezultateve të shkollës së mesme për pranimin në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në vitin akademik 2025-2026, **duhet të jetë e barabartë ose më shumë se 6,5** (referuar sistemit arsimor shqiptar);
- të mos jenë të regjistruar njëkohësisht në programe të tjera studimi në të njëjtin vit akademik, në universitete publike dhe/ose private, vendase dhe/ose të huaja.

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nëpërmjet testeve të pranimiit për Mjekësi dhe Kirurgji në italisht, të cilat konsistojnë në:

1. Test me shkrim në italisht, në formën e pyetjeve, për të vlerësuar njohuritë e konkurrentëve në Shkencat (Biologji, Fizikë, Kimi dhe Matematikë)	30 pikë
2. Test me shkrim për njohuritë e gjuhës italiane	20 pikë
3. Nota Mesatare e Shkollës së Mesme	30 pikë
Gjithsej	80 pikë

Testet e pranimiit do të zhvillohen në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri, në datat e mëposhtme:



UNIVERSITÀ CATTOLICA NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

Programi i studimit	Data	Ora
Programi i Studimit Master Shkencor i Integruar në <i>Mjekësi dhe Kirurgji</i>	20.08.2025	10:00

Pjesëmarrësit në provimet e pranimit duhet të paraqiten në Sekretarinë Mësimore të paktën 30 minuta para fillimit të provimit përkatës, të pajisur me një dokument identifikimi (kartë Identiteti/pasaportë). Është e ndaluar të futen dhe të mbahen gjatë provimit pajisje komunikimi elektronike (telefon celular, i-Phone, i-Pad, etj.). Pjesëmarrësit që kapen duke mbajtur këto pajisje do të përjashtohen menjëherë nga procedura e konkurimit.

Renditjet do të bëhen në bazë të rezultateve përfundimtare individuale, duke ndjekur rendin në rënie të pikëve të fituara, dhe do të publikohen në ambientet e Universitetit dhe në faqen zyrtare www.unizkm.al më datë **25 gusht 2025**. Kandidatët mund të përjashtohen nga renditja në rast se konstatohen parregullsi në dokumentacionin e dorëzuar për regjistrimin në provimet e pranimit.

Kandidatët shqiptarë që paraqesin kërkesë për pranim në portalin U-Albania

I. Paraqitja e kërkesës për pranim

Për të paraqitur kërkesën për pranim në raundin e dytë, duhet të për zgjidhen paraprakisht në portalin online U-Albania (<https://ualbania.arsimi.gov.al/>) Programet e Studimit të Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", në periudhën nga data **29 korrik deri më 3 gusht 2025**.

Për të marrë pjesë në provim, kandidatët duhet të paraqiten **nga 08 deri më 18 gusht 2025, brenda orës 16:30**, pranë:

- Zyrës së Pranimit të Studentëve në Universitet për të paguar tarifën prej 2,000 lekësh për pjesëmarrje në provimin e pranimit. Kandidatët duhet të jenë të pajisur me kartën e identitetit/pasaportën dhe formularin e aplikimit të printuar nga portali U-Albania.
- filialeve të Bankës Intesa SanPaolo në llogarinë rrjedhëse¹ me të dhënat e mëposhtme:
Përfutuesi: Fondazione Zoja e Këshillit të Mirë (Universiteti Katolik)
IBAN AL06208112040000030694935304 për pagesat në Lekë.
- me kartë krediti online në portalin e Universitetit: <https://admissions.unizkm.al>

II. Regjistrimi / Imatrikulimi

Kandidatët shqiptarë që shpallen fitues në provimet e pranimit në raundin e dytë, duhet të regjistrohen në Sekretarinë Mësimore në periudhën nga **29 gushti deri më 11 shtator 2025**, sipas modaliteteve të parashikuara në thirrjen Nr. të vitit 2024. Sipas Urdhrit Ministror nr. 12 datë 30.06.2024 dhe Urdhrit të Përbashkët të QSHA-RASH nr. 157 datë 03.06.2025, të përditësuar, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, kjo periudhë ndahet në 7 faza nga 48 orë secila (29- 30; 31- 01; 02- 03; 04- 05; 06- 07; 08-09; 10-11). Këto faza vazhdojnë deri në plotësimin e vendeve të disponueshme dhe përfundojnë **më datë 11 shtator 2025**.

¹ Ju lutemi të specifikoni në Urdhrit e pagesës emrin dhe mbiemrin, si dhe programin/programet e studimit për të cilat bëhet pagesa. Në ditën e provimit është e nevojshme të paraqisni kopjen e urdhrin të pagesës, pasi koha për akreditim është e kufizuar.



UNIVERSITÀ CATTOLICA NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

Për qëllim të regjistrimit, kandidatët që shpallen fitues të provimeve të pranimit duhet të dorëzojnë në Sekretarinë Mësimore, vetë ose përmes një përfaqësuesi të pajisur me autorizim, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Faturë e pagesës së bërë në bankë për këstin e parë ose për tarifën vjetore² (fletëpagesa e shkarkueshme nga portali i studentëve: portal.unizkm.al, seksioni: "Tarifat");
- Kopje e noterizuar e Diplomës së Shkollës së Mesme /për kandidatët e diplomuar jashtë vendit, kopje e noterizuar e dokumentit të Ekuivalencës së Diplomës së Shkollës së Mesme, e lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore e Republikës së Shqipërisë, së bashku me kopjen e noterizuar të Certifikatës së Shkollës së Mesme me notat;
- Certifikata Ndërkombëtare e Njohurive Gjuhësore në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor" dhe në përputhje me Urdhrat Ministrorë në fuqi (nëse kandidati ka detyrimin ta dorëzojë);
- Dy foto, format pasaporte.
- Certifikata Mjekësore e Përshtatshmërisë për të studiuar;
- Dëshmia e Vendbanimit;
- Certifikata Familjare;
- Kopje e një dokumenti të vlefshëm identifikimi (Kartë Identiteti ose Pasaportë);
- Dy foto, format pasaporte.

Pranë Sekretarisë Mësimore do të plotësohen gjithashtu:

- Kërkesa për Regjistrim (mund të shkarkohet edhe nga Portali i studentëve: portal.unizkm.al);
- Deklaratat e formulara sipas Shtojcave nr. 1 dhe nr. 2 të Urdhrit Ministror nr. 12 dt. 30.06.2023.
- Kontrata e Regjistrimit;

Proçesi i çregjistrimit

Kandidati ka të drejtë të paraqesë kërkesën për çregjistrimit nga studimet në Sekretarinë Mësimore dhe të tërheqë dokumentet e dorëzuara për regjistrim **në datat 12 – 13 shtator 2025**. Nëse kërkesa nuk bëhet brenda këtyre datave, kandidati nuk do të ketë më të drejtë të ndryshojë programin e studimit për vitin akademik në fjalë. Kërkesa për heqje dorë nga studimet bëhet në portalin U-Albania dhe në Sekretarinë Mësimore.


Rektori

Prof. Leonardo Palombi

² Në rast se kandidati përbush kriteret e parashikuara në Rregulloren e Tarifave të Studimit për të përfituar kontributin për studimet, shuma që duhet të paguhet do të ulet në përpjesëtim me tarifën që mbetet.